

Kryetarja e Parlamentit
të Zvicrës vizitoi
gratë e Krushës

FAQE 2

Bujtinat tradicionale - vendi
ku përjetohet mënyra
rugovase e jetesës

FAQE 3


Trajnim përmes
aplikacionit për
mesazhe për gratë rurale

FAQE 4

2020
DHJETOR

BULETINI.

PROMOVIMI I
PUNËSIMIT NË
SEKTORIN PRIVAT



Platforma digjitale në mbështetje të bizneseve lokale

Ndërsa bota u digjitalizua gjithnjë e më shumë gjatë vitit 2020, kjo risi u shndërrua në sfidë dhe mundësi edhe për bizneset e Kosovës që të përshtaten, transformohen dhe evoluojnë. Eksperimentimi me kanale të ndryshme online për shitje, zhvendosja e operacioneve krejtësisht online ose rritja e pranisë online ishin disa nga veprimet e menjëhershme dhe afatmesme që partnerët tanë vunë në lëvizje.

Për ta lehtësuar reagimin e partnerëve tanë ndaj kërkesave të momentit dhe për të hedhur themelet digjitale për afat më të gjatë, Agjencia Zvicereane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) përmes projektit Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat (PPSE) mbështeti disa nisma digjitale të bizneseve nga sektorët e ushqimit dhe përbërësve natyrorë dhe turizmit. Nevojat e tyre të ndryshme ndikuan në modelet e biznesit dhe natyrën e përkrahjes që nevojitej.

Një nga sfidat dhe pengesat më të mëdha për

fermerët, prodhuesit dhe kompanitë e përpunimit të ushqimit këtë vit ishte çrregullimi i kanaleve tradicionale të shitjes: tregjet, restorantet dhe dyqanet. Për ta adresuar situatën, PPSE hyri në partneritet me disa aktorë të sektorit privat që reagues menjëherë për të krijuar kanale të reja online për këto produkte.

‘Shija e Kosovës Online’ është platforma më e re online që pritet të lansohet së shpejti nga GjirafaMall.com. Ajo do të mundësojë kanale të reja për shitje dhe promovim të rreth 30 bizneseve lokale që ofrojnë produkte ushqimore finale. Bashkë me platformat www.shitjaonline.com që krijojnë e-dyqane për ushqimore, furra buke, restorante, kafeteri dhe të tjerë dhe www.fizza.shop – një vend ku ushqimet blihen online, këto kanale online të shitjes u shërbejnë edhe prodhuesve, edhe konsumatorëve.

Në sektorin e turizmit, platforma më e re

digjitale www.kosovapass.com po funksionon prej disa muajsh. Kjo platformë u mundëson operatorëve turistikë të blejnë dhe shesin online produkte turistike, ndërsa klientëve që të kenë përvojë nëpër natyrën e Kosovës, me vetëm një klikim.

Partneri ynë tjetër, United Pixels Academy, këtë vit ka hedhur hapa të mëdhenj. Së pari, ata organizuan me sukses kurset e trajnimit online për dizajnerë grafikë dhe menaxhim të medias sociale. Këto kurse u dizajnuan për të përbushur nevojat e bizneseve. Më pas, aktiviteti evolui në platformën që sapo e kanë lansuar www.krypune.com ku profesionistët e lirë dhe bizneset mund të gjejnë punësim dhe shërbime profesionale.

Të gjitha këto nisma ndërthurin me lehtësi shndërrimin digjital dhe ndikimin e tij në përgjithësi mbi ekosistemin e sektorit privat, duke krijuar më shumë mundësi dhe vende të reja pune.

INFORMATAT KRYESORE NGA PUNA JONË

Platformë për rrjetëzim dhe marketing ndërkombëtar

■ “Shoqata e Përpunuesve dhe Eksportuesve Kosovarë të Produkteve Pyjore Jodrusore dhe Bimëve Aromatike Mjekësore ORGANIKA ofron tashmë qasje globale në të gjithë informacionin për sektorin përmes një [databazë të integruar në uebfaqen e vet](#). Kjo databazë e sektorit u jep përfaqësuesve të interesuar nga bizneset e huaja dhe vendore qasje në informata të hollësishme dhe të dobishme për bizneset individuale në Kosovë, si dhe informata të dobishme për bërjen biznes. Qëllimi i databazës është ta promovojë këtë sektor të ekonomisë së Kosovës me fokus të posaçëm tek tregjet e huaja, si dhe të rrisë mundësitë për rrjetëzim dhe eksport, që nga ana e tyre i kontribuojnë krijimit të vendeve të reja të punës. Databaza përmban informacion të hollësishëm për produktet/shërbimet e secilës kompani si dhe informatat kontaktuese. Ajo është një mjet shtesë për të lehtësuar qasjen në informacion për partnerë potencialë të biznesit me fokus tek lidhjet ndërkombëtare të biznesit. Databaza e ORGANIKA-s është zhvilluar me përkrahjen e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim përmes PPSE-së.



Kryetarja e Parlamentit të Zvicrës vizitoi gratë e Krushës

■ “Të gjithë dalin të fituar nga modeli i bujqësisë së kontraktuar: kontraktorët dhe fermerët”. Fahrije Hoti, themeluese e “Kooperativës së Grave të Krushës” ndau mendimin e saj për këtë model të bujqësisë, të promovuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim në Kosovë, me Kryetaren e Parlamentit të Zvicrës Isabelle Moret. Në nëntor 2020, Zonja Moret,

e shoqëruar nga Deputeti Mauro Tuena dhe Ambasadori Thomas Kolly vizitoi “Kooperativën e Grave të Krushës”, ku u takuan me punëtorët, menaxherët dhe fermerët e kontraktuar të kooperativës. Znj. Hoti rrëfeu historinë se si u krijua kooperativa, sfidat e saj dhe zhvillimin ndër vite, si po ecën puna dhe planet për zgjerim në të ardhmen.

Fidanët e specializuar bëjnë ndryshimin për fermerët

■ Jeta e një fermeri bëhet shumë më e lehtë kur teknologjia moderne e prodhimit të fidanëve bëhet bashkë me ekspertizën e duhur. Fidanët e prodhuar për fermën e Visar Vokrrit demonstrojnë se ai nuk e kishte paramenduar që një cilësi e tillë ishte e mundur. “Të sigurosh fidanë të shëndetshëm, të gatshëm për t’u mbjellë, kursen kohën, mundin dhe burimet. Gjithashtu, prodhuesi i fidanëve ishte gjithnjë në dispozicion për këshilla dhe përkrahje shtesë” thotë Visari, një fermer i ri nga rajoni i Podujevës. Ai shfrytëzoi një parcelë për të mbjellë lakra me fidane të prodhuar

nga Agrobora dhe me fidane të rritura në mënyrë tradicionale: dallimi shihet edhe me sy, sikurse thotë ai.

“Kjo cilësi është rezultat i vënies në zbatim të teknologjisë së avancuar për prodhimin e fidanëve në fidanishten tonë. E falenderojmë stafin e PPSE-së, Sherif Kuçin për idetë e tij dhe prof. Astrit Balliun për këshillat profesionale” thotë Flamur Sylja nga Agrobora, fidanishtja e parë e specializuar për prodhimin e fidanëve që u hap vitin e kaluar në Kosovë me përkrahje nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim.





Bujtinat tradicionale – vendi ku përjetohet mënyra rugovase e jetesës

■ Një nga format më të parapëlqyera të akomodimit për turistët e huaj, por edhe për vizitorët vendas, janë bujtinat tradicionale. Një ditë e zakonshme në bujtinë nis shumë herët në mëngjes, ende pa lindur dielli. Familjarët që e menaxhojnë bujtinën përgatisin mëngjesin: vezë të fshatit, djathë, kos, mazë, petulla, palëpeta, bukë e shtëpisë, perime të kopshtit, reçel dhe fruta, çaj dhe kafe. Mëngjes i pasur, përgatitur me bujari që u jep vizitorëve energjinë e duhur për ditën që i pret.

Kështu e rrëfejnë ditën e tyre Xhevahire dhe Ilir Shala. Çifti menaxhon bujtinën “Shqiponja” në fshatin Drelaj. E rrethuar nga gjelbërimi i maleve dhe pemët e lulet e kopshtit të rregulluara me estetikë, kjo bujtinë që duket si në përralla, që nga viti 2011 pret e përcjell mysafirë të të gjitha moshave, nga e gjithë bota. Teksa shfletojnë librin e përshtypjeve, mesazhe falenderuese në dhjetëra gjuhë krijojnë atlasin e vendeve prej nga kanë ardhur miqtë e kësaj bujtine.

“Më së shumti vijnë gjermanë, por edhe nga vende të tjera” tregon Iliri. Më herët, ai është marrë me punë të ndryshme në fermën familjare dhe ka pasion gdhendjen e drurit. Tashmë prej pothuajse dhjetë vitesh, pret mysafirë në bujtinë. Në këtë aktivitet janë përfshirë edhe familjarë të tjerë. Ushqimet i blejnë nga banorët e fshatit.



Në kuadër të bujtinës, familja Shala ka dy shtëpi me kapacitet prej 30 vetësh. Përveç dhomave të fjetjes, bujtina ka dhe hapësirat e përbashkëta ku turistët dhe mikpritësit kalojnë kohë së bashku. Investimi në rregullimin e hapësirës është i vazhdueshëm, edhe pse jo gjithnjë i lehtë në aspektin financiar, sidomos këtë vit që pandemia e COVID-19 ka prekur rëndë të gjithë sektorin e turizmit.

“Kemi patur rreth 36 grupe të rezervuara për këtë sezon, por asnjëri nuk u realizua” tregon Iliri. Por edhe pse ka qenë periudhë e vështirë, ai është marrë me rregullimin e bujtinës. “Kemi rregulluar hapësirën ku mysafirët hanë, e kemi mbyllur me xhama dhe e kemi rregulluar këtë ambient të ngrohtë dhe përshtatëm” tregon Iliri, duke shtuar se investimi u bë i mundur falë përkrahjes nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) në Kosovë, përmes projektit të Swisscontact që mbështet turizmin. “Kjo ka qenë e vetmja ndihmë në këtë periudhë të vështirë” thotë ai.

Bujtina Shqiponja është një nga 10 bujtinat përfituese të kësaj përkrahjeje nga SDC në kuadër të aktivitetit për renovimin e bujtinave në Rugovë që të jenë të gatshme të presin mysafirë në kushte edhe më të mira, sapo të rifillojë qarkullimi i lirë.

Ky artikull është publikuar së pari në revistën Albinfo.ch në tetor 2020.



A E KENI DITUR SE...?

A

...mund të bëni një shëtitje nëpër 400 metrat e Shtegut të Natyrës në Pyllin e Arinjve PRISHTINA dhe të përjetoni në të njëjtën kohë edhe natyrën paqësore, edhe të mësoni më shumë për të? Pylli i Arinjve PRISHTINA, rreth 20 km nga kryeqyteti, kombinon mirëqenien e kafshëve, turizmin e qëndrueshëm dhe edukimin mjedisor për të gjitha moshat. Shtegu i Natyrës dhe Parku i Argëtimit janë pjesa e re e sapopëruar, që u mundësuan nga bashkëinvestimi ndërmjet Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe Vierpfoten Kosova. Kjo hapësirë ofron mundësi rekreacioni dhe edukimi për vizitorët, duke ia shtuar atraksionin këtij parku. Produktet rekreative dhe edukative, si kodra e milingonave, labirinti, shpella e ariut, rrjeta e merimangave, çerdhja e zogjve kanë tabela me informata për rolin dhe funksionin e secilës.

B

...mund t'i shtoni ushqimit tuaj shije dhe përbërës arrorë, të prodhuara në Kosovë? Ju duhet vetëm të vizitoni dyqanin artizanal Peline's (<http://www.pelinis.net>) në Prishtinë. Llojet e gjalpërave dhe vajrave me bazë arrorë janë produktet tipike të Peline's, një biznes familjar i themeluar në vitin 2018. Si promovues i qasjes “nga ferma në tryezë”, kompania kryesisht përdor produkte të blera nga fermerët lokalë. Dyqani në Prishtinë ndjek filozofinë zero-mbeturina pasi shet artikuj ushqimorë të freskët, të papaketuar. Në partneritet me PPSE-në, kompania po zgjeron kapacitetet e prodhimit.

C

...së shpejti, një kështjellë mesjetare do t'i shtohet ofertës turistike të Graçanicës? Ndërtimi i parkut tematik rreth njëzetë metra nga Manastiri është afër përfundimit. Parku tematik shtrihet mbi një sipërfaqe prej 670 metrash katrorë dhe përbëhet nga një kullë, muze, kullë vëzhgimi dhe objekte të tjera që e plotësojnë infrastrukturën: një minimarket, një dyqan suvenirësh, një tavernë mesjetare dhe një terren shigjetarie. Projekti është financuar pjesërisht nga PPSE.

D

...çfarë përmban një “fruit bar” (biskotë me fruta) me shije të ndryshme? Partneri ynë Kodra e Diellit ka testuar tashmë së paku 10 receta me shije të reja – përzierje e frutave të ndryshme dhe përbërësve të tjerë. Këto produkte të reja janë rezultat i bashkëpunimit ndërmjet Kodra e Diellit dhe Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim që konsiston në bashkëfinancimin e makinerive për të prodhuar rollada dhe biskota me fruta, që është implementuar përmes PPSE.

MODELI PËR NDRYSHIM

Trajnim përmes aplikacionit për mesazhe për gratë rurale

Në fillim të vitit 2020, Arbësa Lushtaku Ve- liu, agronome e sapodiplomuar, u punësua në Agroflorentina, një kompani që merret me grumbullimin, kultivimin dhe përpunimin e kërpudhave të egra, frutave të pyllit dhe bimëve aromatike.

Vetëm disa muaj pasi nisi punën e saj të parë, gjithçka ndryshoi për shkak të pandemisë së COVID-19. Kufizimi i lëvizjeve dhe masat e shtuara për kujdes shëndetësor trazuan jetët e të gjithëve. Për gratë rurale, kjo nënkuptonte më pak mundësi për punë fitimprurëse, madje edhe më pak qasje se më parë në mundësi trajnimi, rrjetëzimi dhe perspektiva të reja.

Bashkë me 26 gra të tjera që merren me kultivimin e bimëve mjekësore aromatike (BMA) në të gjithë Kosovën, në fillim të sezonit të verës Arbësa u regjistrua në një trajnim 4-javor për menaxhimin e kultivimit të BMA-ve. Ky trajnim zhvillohet rregullisht nga Shoqata e Përpunuesve dhe Eksportuesve Kosovarë të Produkteve Pyjore Jodrusore ORGANIKA. Por këtë vit pati një vëshirësi: COVID-19.

Zgjidhja ishte e qartë, të ofrohej trajnim online. Mirëpo, përdorimi i platformave online më të avancuara për trajnim kërkon një shkallë të caktuar të familjarizimit me to dhe shkathësi në përdorimin e mjeteve të kësaj teknologjie. “Gratë që jetojnë në zonat rurale nuk mundën gjithnjë të gjejnë kohë dhe të përcjellin ligjëratat on-

line në orarin e caktuar, për shkak të ngarkesës me punë dhe detyrimeve të ndryshme në fermë dhe ekonomi familjare” thotë Faton Nagavci, Drejtori Ekzekutiv i ORGANIKA-s.

Zgjidhja që u gjet ishte sa e thjeshtë, aq edhe krijuese: trajnimi u mbajt përmes Viber-it, softuer për shkëmbime mesazhesh në kohë reale që është mjaft i popullarizuar në Kosovë, e sidomos përdoret nga gratë në zonat rurale.

ORGANIKA krijoi pesë grupe në Viber, nga një grup për pjesëmarrëset e secilës kompani. Materialet e përgatitura për trajnimin ishin të përshtatshme për Viber në formatin e videove të shkurtra shpjeguese, posterave dhe këshillave në formë teksti. Ndarja në grupe e bëri më të lehtë diskutimin mes pjesëmarrëseve, ato e kishin më të lehtë të kërkonin sqarime apo informata shtesë lidhur me materialet në video.

Arbësa thotë “trajnimi ishte shumë i dobishëm, sidomos për gratë e përfshira në kultivim.



Duke qenë se sapa kam nisur të mësoj për menaxhimin e fermës, mësova shumë për kultivimin dhe mbajtjen e shënimeve. Mënyra si u mbajt trajnimi ishte e duhura, ndoshta edhe më e kuptueshme se sa thjeshtë të dëgjonim ligjëratat. Dhe platforma e përzgjedhur, Viber, ishte e duhura, pasi ishte shumë e lehtë për pjesëmarrëset që ta përdorin. Ato janë shumë të kënaqura me programin.”

[Klikoni këtu](#) për të lexuar rrëfimin e plotë të publikuar me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas Rurale.



TRAJNIM ONLINE PËR GRATË QË PUNOJNË NË SEKTORIN E BIMËVE AROMATIKE DHE MJEKËSORE

KULTIVIMI I BIMËVE MJEKËSORE AROMATIKE DHE MENAXHIMI I FERMËS TUAJ



SHOQATA ORGANIKA
2020

Rr. Sylejman Vokshi Nr.42 |10000 Prishtinë, Kosovo
Tel: +383(0)38220403
email: ppseinfo@swisscontact.org
website: www.ppse-kosovo.org and www.swisscontact.org/kosovo
www.facebook.com/ppse.kosovo
https://twitter.com/PPSE_Kosovo
<https://www.instagram.com/ppsekosovo/>

Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat

Projekti Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim implementohet nga Swisscontact dhe Instituti Riinvest.